



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE



V E N D I M

Nr. 859, datë 7.12.2016

PËR

**MIRATIMIN E DOKUMENTIT “STANDARDET SHTETËRORE
PËR SPECIFIKIMET TEKNIKE TË INFORMACIONIT
GJEOHAPËSINOR NË SHQIPËRI - TEMA : SISTEMI I ADRESAVE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 11, pika 2, shkronja “dh”, e 16, pika 1, të ligjit nr.72/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e dokumentit “Standardet shtetërore për specifikimet teknike të informacionit gjeohapësinor në Shqipëri – Tema: Sistemi i adresave”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohen ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG) dhe autoritetet përgjegjëse për krijimin, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave gjeohapësinore për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

MINISTRI I SHTETIT PËR INOVACIONIN
DHE ADMINISTRATËN PUBLIKE

MILENA HARITO

NR.PROT.6449/3
DATË 12.12. 2016

MINISTRISË SË FINANCAVE
MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME
MINISTRISË SË TRANSPORTIT DHE
INFRASTRUKTURËS
MINISTRISË SË ZHVILLIMIT URBAN
MINISTRIT TË SHTETIT PËR ÇËSHTJET VENDORE
MINISTRIT TË SHTETIT PËR INOVACIONIN DHE
ADMINISTRATËN PUBLIKE
ASIG-UT
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjell AGACI

